

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE
“ÇOBA –HOTELERI” SH.P.K.

Ky statut do të konsiderohet se përfshin dhe Aktin e Themelimit të Shoqërisë, organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot më 29.11.2022, ortakët themelues

- 1- Elton Çoba, shtetas shqiptar lindur më 07.03.1980, lindur në Selitë, Krujë, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr personal I00307082J madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar
- 2- Ela Çoba, shtetase shqiptare lindur më 05.03.1987, lindur në Laç, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr personal I75505155I madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008”Për shoqëritë tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratojnë këtë statut si vijon:

Në këtë Statut:

-“Ligji” është Ligji 9901/2008 ”Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” i ndryshuar

-“Statuti” është ky statut i Shoqërisë

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja

Neni 1

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit, Selia

Sot ,më 29.11.2022 ,ne,themeluesit e mësipërm,kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin tregtar”Çoba-Hoteleri” SH.P.K.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm:

Hoteleri

Në funksion të qëllimeve të mësipërme Shoqëria mund të hyjë në tregje dhe operacione të ndryshme,të zotërojë pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe/ose pjesmarrje në shoqëri të tjera tregtare.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.



Neni 4

Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresë: Autostrada Milot-Mamurras,Ndërtesë 2 katëshe,ZK nr.1677 me Pasuri nr.28/79,Fush Milot,Milot,Laç,Lezhë.

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 200.000(Dyqindmije)Lekë dhe është i ndarë në 2(dy)kuota .Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

a-Ortaku themelues Elton Çoba zotërues i nje kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (Njëqindmijë)Lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë..

b-Ortaku themelues Ela Çoba zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (Njëqindmijë)Lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë..

Kontributi i ortakëve është në para.

Secili ortak do të ketë një numër proporcional votash me vlerën nominale të kuotës së tij.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet ne para dhe me anë të kontributeve në natyrë,nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që perfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

-Kontributit në kapitalin e shoqërisë

-Shitblerjes

-Trashëgimisë



-Dhurimit

Çdo mënyrë tjetër e parashikuar me ligj

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nëpërmjet ortakëve,për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rruge trashëgimie.

Kreu III

Organet vendimmarrëse dhe drejtuese

Neni 8

Organi vendimmarrës

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

a-Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë

b-Ndryshimet e statutit

c-Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve

d-Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar

e.Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d të kësaj pike.

f.Mbikqyerjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët,përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

g-Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

h.Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.

i-Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.

j.Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

k.Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

l.Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë.

m.Shpërndarjen e fitimeve vjetore.



n.Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administrator i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes sëmbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statute, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet të gjithë ortakëve , jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marrë vendime , pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 30% të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votive, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë në të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të zotëruesve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës , për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votimeve të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë.



Neni 12

Përfashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë të tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet si administrator i shoqërisë për një mandatë të plotë 5 (pesë) vjeçar emërimi:

Z. Elton Çoba, shtetas shqiptar, lindur më 07.03.1980, lindur në Selitë, Krujë dhe banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal I00307082J, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, pa kufizime në kompetencat e administrimit.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertët

Neni 14

Viti financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor. Përfashtimisht, viti I parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 dhjetor.

Neni 15

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë të gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara të cilat është i detyruar që tja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu 5

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 16

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë kur mbaron kohëzgjatja e



parashikuar në themelimin e saj;me vendim të asamblesë së ortakëve;me hapjen e procedurave të falimentimit;në përpythje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2017;me vendim të gjykatës.

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në te cilin parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë duke caktuar një apo disa likujdatorëdhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë”Shoqëri në likujdim e sipër”.Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likujdimit në gjëndjen e aftësisë paguese,me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit që janë emëruar nga Ortakët.Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likujduesve.Brenda 30 diteve pas prishjes,çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës për të caktuar njëe likujdues.

Neni 17

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet,bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve,në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën VIII të ligjit 9901 datë 14.04.2012”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 18

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut,dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.Për sa nuk parashikohet në këtë statut,do të zbatohen dispozitat e ligjit”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”,kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specific në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti,si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis shoqërisë dhe të tretëve,do te jetë kompetente gjykata shqiptare.

Ky akt u hartua në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua,u kuptua dhe u nënshkrua nga ortaku themelues si vijon:

**ORTAKËT THEMELUES
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ÇOBA-HOTELERI”SH.P.K**

Z.ELTON ÇOBA



Zj.ELA ÇOBA

